


Tregtia e jashtme e mallrave

Mars 2018

Tiranë, më 17 Prill 2018: Në Mars 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 27 mld lekë, duke u rritur me 14,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 13,3 %, në krahasim me Shkurt 2018. Importet e mallrave në Mars 2018 arritën vlerën 55 mld lekë, duke u rritur me 2,2 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 20,2 %, në krahasim me Shkurt 2018. Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u ulur me 7,3 %, krahasuar me Mars 2017 dhe duke u rritur me 27,6 %, në krahasim me Shkurt 2018.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në tre mujorin e parë të vitit 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 74 mld lekë, duke u rritur me 18,9 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 146 mld lekë, duke u rritur me 9,6 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 71 mld lekë, duke u rritur me 1,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 14,5 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +5,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +3,4 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,7 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar negativisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,1 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Mars 2018




Eksportet, gjatë këtij tremujori janë rritur me 18,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +5,2 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,7 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 2,2 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +4,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,1 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me +0,8 me pikë përqindje. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,1 pikë përqindje “Produkte kimike dhe plastike” me -1,8 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,3 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Mars 2018



Në tremujorin e parë të vitit 2018 importet janë rritur me 9,6 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të 2017. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +3,3 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me +1,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me -0,7 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Mars 2018, vendet kryesore me të cilët Shqipëria ka pasur rritje të eksporteve, në krahasim me Mars 2017 janë: Italia me (1,1 %), Spanja me (162,1 %) dhe Gjermania me (25,0 %). Ndërsa vendet kryesore me të cilat eksportet kanë pasur ulje janë: Kosova me (-13,2 %), Kina me (-35,2 %) dhe Maqedonia me (-20,0 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet kryesore me të cilët Shqipëria ka pasur rritje të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (5,4 %), Spanja me (138,2 %) dhe Gjermania me (37,0 %). Ndërsa vendet kryesore me të cilat eksportet kanë pasur ulje janë: Kosova me (-1,2 %), Kina me (-4,5 %) dhe Maqedonia me (-7,1 %).

Në muajin Mars 2018, vendet kryesore me të cilët Shqipëria ka pasur rritje të importeve, në krahasim me Mars 2017 janë: Italia me (1,7 %), Gjermania me (18,6 %) dhe Kina me (15,9 %). Ndërsa vendet kryesore me të cilat importet kanë pasur ulje janë: Turqia me (-4,0 %), Greqia me (-2,5 %) dhe Serbia me (-38,7 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet kryesore me të cilët Shqipëria ka pasur rritje të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia me (6,7 %), Gjermania me (9,8 %) dhe Greqia me (14,4 %). Ndërsa vendet kryesore me të cilat importet kanë pasur ulje janë: Serbia me (-16,1 %), Spanja me (-0,4 %) dhe Egjipti me (-17,3 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Mars 2018



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 70,2 %, të gjithë tregtisë. Në Mars 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 65,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,8 %), Gjermania (9,7 %), Greqia (6,7 %) dhe Kina (6,1 %).

Shkëmbimet tregtare, për tremujorin e parë 2018, me vendet e BE zënë 68,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Mars 2018, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 80,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 62,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (35,8 %), Gjermania (7,6 %), Greqia (6,9 %) dhe Kina (6,3 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2016	01 - 16	16	-7,8	35	1,0	-18	47,0
	02 - 16	18	-4,4	42	7,6	-24	42,0
	03 - 16	19	-12,7	47	5,6	-28	41,2
	Janar – Mars 2016	53	-8,6	124	4,3	-70	43,1
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	02 - 17	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	03 - 17	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	Janar – Mars 2017	63	17,5	133	7,7	-70	47,1
2018	01 - 18	24	24,4	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,7	46	4,3	-22	52,0
	03 - 18	27	14,5	55	2,2	-28	49,0
	Janar – Mars 2018	74	18,9	146	9,6	-71	51,0

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Mar-17	Mar -18	Jan.- Mar . 2017	Jan.- Mar.2018	Mar-17	Mar -18	Jan.- Mar . 2017	Jan.- Mar.2018
Vendet e BE-së	17.643	21.639	49.087	59.747	34.341	36.034	82.312	91.138
Austri	139	163	294	495	448	482	1.089	1.393
Mbretëri e Bashkuar	18	77	71	158	492	373	1.190	1.194
Gjermani	1.023	1.278	2.635	3.611	5.667	6.723	11.925	13.099
Greqi	1.083	1.218	2.739	3.359	4.369	4.260	10.370	11.859
Itali	12.759	12.905	35.785	37.708	15.432	15.694	38.524	41.102
Spanjë	871	2.284	2.684	6.393	1.260	877	2.678	2.667
Kroaci	60	65	151	183	324	334	905	1.492
Të tjera të BE-së	1.691	3.648	4.728	7.840	6.350	7.290	15.630	18.332
Kinë	1.205	781	2.515	2.401	3.649	4.229	10.560	11.472
Kosovë	1.713	1.488	4.106	4.058	740	732	1.596	1.613
Maqedonia	743	595	1.629	1.513	787	734	1.690	1.768
Rusi	-	0	6	6	577	822	1.891	2.484
SHBA	461	457	705	1.309	840	922	2.264	2.279
Turqi	203	144	482	354	4.610	4.424	10.899	11.767
Ukrainë	49	37	171	62	310	146	850	541
Zvicër	16	98	284	765	1.151	624	2.341	2.921
Të tjera	1.587	1.806	3.661	4.247	6.947	6.492	18.721	19.909
Gjithsej	23.622	27.044	62.646	74.462	53.951	55.158	133.125	145.893

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Mar-17	Mar -18	Jan.- Mar . 2017	Jan.- Mar. 2018	Mar-17	Mar -18	Jan.- Mar . 2017	Jan.- Mar. 2018
Gjithsej	23.622	27.044	62.646	74.462	53.951	55.158	133.125	145.893
Ushqime, pije, duhan	2.005	2.412	4.846	6.002	9.135	9.464	22.992	24.519
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	4.356	5.643	11.945	13.628	4.885	4.184	12.420	15.698
Produkte kimike dhe plastike	414	380	958	1.178	8.341	7.360	20.441	19.482
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	252	265	635	730	1.316	1.722	3.572	4.343
Prodhime druri dhe letre	617	713	1.792	2.147	2.030	1.983	4.790	5.165
Tekstile dhe këpucë	10.084	10.887	28.221	31.488	7.156	7.766	19.158	20.686
Materiale ndërtimi dhe metale	4.218	4.558	9.730	13.218	7.309	6.150	15.692	17.007
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.144	1.482	3.025	4.070	11.769	14.123	28.907	33.324
Të tjera	531	704	1.493	2.001	2.011	2.406	5.154	5.667

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	35.785	37.708	2.684	6.393	4.106	4.058	2.635	3.611
Ushqim, pije duhan	1.509	1.902	227	252	419	429	364	294
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	3.519	561	1.922	5.256	1.333	336	467	591
Produkte kimike dhe plastike	309	348	1	11	257	208	3	7
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	494	588	4	61	-	1	0	3
Prodhime druri dhe letre	1.310	1.525	1	282	81	101	26	39
Tekstile dhe këpucë	22.284	24.299	448	475	29	23	1.298	2.039
Materiale ndërtimi dhe metale	3.674	4.904	76	48	1.629	2.570	290	213
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.906	2.523	0	2	128	145	153	291
Të tjera	780	1.058	3	6	229	244	34	133

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Gjermani		Greqi		Turqi	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	38.524	41.102	11.925	13.099	10.370	11.859	10.899	11.767
Ushqim, pije duhan	3.954	4.395	890	951	3.069	3.630	1.370	1.298
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	3.858	2.758	157	119	1.355	1.913	276	112
Produkte kimike dhe plastike	4.313	3.995	1.706	1.804	1.905	1.656	1.593	1.812
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.780	3.385	1	38	9	27	69	70
Prodhime druri dhe letre	1.407	1.685	159	161	546	691	730	617
Tekstile dhe këpucë	9.557	10.368	540	597	845	963	3.459	3.690
Materiale ndërtimi dhe metale	4.047	5.101	1.905	379	1.703	1.994	1.238	1.977
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	7.330	7.966	6.164	8.662	534	647	1.675	1.584
Të tjera	1.278	1.448	402	388	404	336	489	608

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri